

VENDIM
Nr.192, datë 30.6.2008

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË POSAÇËM PARLAMENTAR PËR KODIN
ZGJEDHOR**

Në mbështetje të nenit 77 pika 1 të Kushtetutës dhe të nenit 24 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Ngrihet Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Kodin Zgjedhor.
- II. Komisioni ka për detyrë përgatitjen e amendamenteve të nevojshme të kuadrit ligjor për arritjen e standardeve në zgjedhje.
- III. Anëtarësia e Komisionit formohet bazuar në numrin e grupeve parlamentare. Çdo grup parlamentar përfaqësohet me 1 (një) anëtar në Komision.
- IV. Komisioni i Posaçëm Parlamentar drejtohet nga dy bashkëkryetarë, një nga partia Demokratike dhe një nga Partia Socialiste.
- V. Secili anëtar përfaqëson dhe vendos në emër të të gjithë deputetëve që ka në Kuvend grupi që ai përfaqëson. Votat përfaqësuese për secilin anëtar të Komisionit përcaktohen në pikën VII të këtij vendimi.
- VI. Mbledhjet e Komisionit janë të vlefshme kur anëtarët që marrin pjesë në to përfaqësojnë shumicën e vendeve në Kuvend. Vendimet në Komision merren kur votat “pro” përfaqësojnë shumicën e vendeve në Kuvend, por, në çdo rast, kur pro tyre kanë votuar në unanimitet të dy bashkëkryetarët e Komisionit.
- VII. Përbërja e Komisionit dhe votat përfaqësuese janë si më poshtë:

1.Illir Rusmali	(PD	42 vota)
2.Fatmir Xhafa	(PS	33 vota)
3.Arjan Madhi	(PR	11 vota)
4.Engjëll Bejtaj	(PSD	7 vota)
5.Ndue Shpani	(PDK	8 vota)
6.Spartak Braho	(LSI	7 vota)
7.Petrit Gjoni	(PAA	7 vota)
8.Tritan Shehu	(PDR	7 vota)
9.Spiro Peçi	(PBDNJ	7 vota)
- VIII. Pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar ngrihet grupi i ekspertëve teknikë. Përbërja dhe mënyra e funksionimit të tij përcaktohen me vendim të Komisionit të Posaçëm Parlamentar.
- IX. Komisioni e ushtron veprimtarinë për një afat prej një muaj nga data e mbledhjes së parë të tij.
- X. Ngarkohet Kryetarja e Kuvendit për krijimin e kushteve të punës dhe mbështetjen logjistike të veprimtarisë së Komisionit.
- XI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)